



Nr. 41 Prot.

Date, 26 .03.2024

Shtojca 21

**FORMULARI I ANKESES PRANE AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TE PROKURIMIT PUBLIK**

**Ankese drejtuar:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë  X  
Adresa: Rruga "5 Maji", Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë  
Tel/Fax: 042227376  
E-mail: [dpn3@tirana.al](mailto:dpn3@tirana.al)

**Ankese drejtuar:** Komisionit te Prokurimit Publik  X  
Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", "Pallati i Kongreseve", Kat i  
Pare, Tirane, Tel: +3554 2281851, Email: [Kpp\\_info@kpp.gov.al](mailto:Kpp_info@kpp.gov.al)

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund te jete nje ofertues ose ofertues i mundshem (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqate, bashkim operatoresh ekonomike)*

**"Kevin Konstruksion" Sh.p.k**

Emri i plote i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**K71401004W**

Nuis/Nipt

**Tirane, Rr. Adem Jashari, Nd. 4, Hyrja 10, Nj Bashkiake nr.5**

Adresa

**Tirane**

**Shqiperi**

**1001**

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

**0684037399**

Numri i telefonit (perfshire kodin e zones)

Numri i faksit (perfshire kodin e zones)

[juristkevin@gmail.com](mailto:juristkevin@gmail.com)

E-mail

**Lavdrim Gjici-Administrator**

Emri dhe titulli i zyrtarit te autorizuar per leshimin e ankeses (ju lutemi shkruani)

Nenshkrimi i zyrtarit te autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0684037399

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II. Informacion mbi procedurën

### 1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotesoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

**REF: 98934-03-20-2024**

### 2. Lloji i Procedurës

*Plotesoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje  
paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje  
paraprake të njoftimit të kontratës

Sherbim Konsulencë

Kontrata e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

### 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.*

**Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**

### 4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

*(Vlera e përlogaritur e kontratës/marreveshjes kuader) (shuma në shifra dhe fjalë)*

**16 829 980 leke pa TVSH;**

### 5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuader

*(Pershkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontratës/marreveshjes kuader).*

## **“Instalimet e sistemeve qendrore të ngrohjes”**

---

6. Afati i fundit per paraqitjen e ofertes

(Data (viti/muaji/dita)

**05.04.2023**

---

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nese eshte e zbatueshme)

---

8. Data e nenshkrimit te kontrates

(Data (viti/muaji/dita) ne rastet e kerkesave per pavlefshmerine e kontrates)

---

### **Seksioni III. Pershkrimi i ankeses**

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar ne vendime, akte, dokumente, etj.)

**Ligji Nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”**

**Vkm Nr.285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”**

2. Objekti i ankeses

- Modifikim i dokumentave te tenderit

- Kundershtim i vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertes tuaj.

—

- Kundershtim i vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertes te nje/disa operatori/ve ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit.

(Citoni operatorin/et ekonomik per te cilin keni pretendime)

- Pavlefshmeri kontrate

*(Citoni kontraten per te cilen kerkoni pavlefshmerine)*

- Tjeter

*(Citoni ketu objektin e ankeses qe nuk perfshihet me siper)*

### **3. Rrethanat dhe faktet**

*Pershkruani rrethanat e faktit.*

1. Ne daten **21.03.2024**, shoqeria jone mori njoftim per publikimin e procedures se prokurimit me te dhenat e referuara me siper.
2. Nga shqyrtimi me kujdes i dokumentave te tenderit konstatuam se disa kriteret kualifikuese jane te pa qarta dhe disa prej tyre nuk jane hartuar ne perputhje me legjislacionin e prokurimeve publike.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Pershkruani ne menyre koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qarte dhe sakte se perse pretendoni per paligjshmeri ne veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

#### **I. Ne piken 2.3.1, te kapacitetit teknik, te Kriteve te Vecanta, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar:**

**2.3.1** Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

➤ Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- **Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);**
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

- *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :*
  - *Kontrate Sipërmarrje;*
  - *Situacionin përfundimtar;*
  - *Fatura tatimore perkatese.*

1. *Kerkesa e autoritetit kontraktor qe krahas kontrates dhe formularit te vleresimit per realizimin e punimeve, vjen ne shkelje te nenit 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 5 te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021)”, ku percaktohen qarte se cfare dokumentacioni duhet te kerkoje autoriteti kontraktor per pervojen e meparshme:*

*5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

2. *Bazuar ne parashikimet ligjore te referuara me siper, del qarte se kerkesa qe krahas **Formularit te vleresimit per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontrates si dhe natyra e punes se kryer)**;*, te paraqiten edhe nje sere dokumentash te tjere si: - *Kontratë Sipërmarrje;* -*Situacionin përfundimtar;* - *Aktin e kolaudimit;*, eshte nje kerkesa qe vjen ne shkelje te hapur te dispozites ligjore te referuar me siper.
3. *Jo me kot Ligjvenesit ka percaktuar qe per punen e ngjashme mjafton te vertetohet me dokumentin final qe e verteton realizimin me sukses te punes dhe nuk e ka pare te nevojshme paraqitjen e te gjithë dokumentacionit qe kane sherbyer per proceduren deri ne pajisjen me vertetim per realizim te kesaj pune.*

4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”
5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
  - b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
  - c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
  - ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.
6. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të LPP-së.
7. Nga sa me sipër, kërkojmë modifikimin e kriterit në përputhje me urdherimet ligjore duke hequr kërkesat për paraqitje të dokumentave si: -Kontratë Sipërmarrje; -Situacionin përfundimtar;- Aktin e kolaudimit;.

## **II. Ne piken 2.3.6, të kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar:**

8. 2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjes, pajisur me diploma/certifikata të formimit profesional lëshuar nga autoritete përgjegjëse të

akredituara/licensuara si dhe deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë vijon;

- 4 (kater) Punonjës hidraulikë
- 3 (tre) Punojes termohidraulike
- 3 (tre) Punonjes mekanikë
- 1 (nje) Punonjës elektro-mekanik
- 2 (dy) Punonjës saldatorë
- 1 (nje) Punonjës kaldaist
- 4 (kater) Punonjes pllakashtrues

Për keta punonjes, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikate te sigurimit teknik leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

9. **Se pari**, Referuar Rekomandimit Nr.6732Prot, date 21.10.2020, te Agjencise se Prokurimit Publik “Mbi Problematikat e Konstatuara gjate Monitorimit te Dokumentave te Tenderit dhe Verifikimit te Procedurave te Prokurimit per Mallra, Pune, Sherbime”, theksohet:



5. Në procedurat e verifikuara nga APP, është konstatuar se, autoritetet kontraktore kërkojnë numër të pa-argumentuar punëtorësh. Ndërkohë, APP sjell në vëmendje se, autoritetet duhet të hartojnë analiza teknike, ku të parashikohen fuqia punëtoresh dhe mjetet/makinëritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Gjithashtu, për kërkesat e dokumenteve të tenderit për punëtorë të kualifikuar të ndarë sipas grupeve të kualifikimit, autoritetet kontraktore duhet të argumentojnë ndarjen e tyre sipas grupeve përkatëse.

Gjatë monitorimit të dokumentave të tenderit, në mjaft raste APP ka konstatuar se, autoritetet kontraktore përcaktojnë në kriteret për kualifikim kërkesa për disponimin nga operatori ekonomik të një numri punonjësish të kërkuar/stafit të nevojshëm, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa për periudha kohore disa mujore, apo edhe më shumë se 1 vjeçare.

Sjellim në vëmendje se, kriteri i disponimit të punonjësve/stafit të kërkuar i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurrohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e përvojave të ngjashme apo besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

Për të provuar eksperiencën, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë, legjislacioni në fuqi ka parashikuar kriterë specifike, të cilat mund të kërkojnë në çdo procedurë prokurimi nga autoritetet kontraktore sipas parashikimeve të nenit 46 të LPP.

Për AK, e rëndësishme është të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi, për sa kohë vërtetohet se ato janë të punësuar pranë operatorit ekonomik në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe figurojnë në listëpagesa në përputhje me legjislacionin përkatës, dhe jo kohëzgjatja e disponimit në periudhën e mëparshme.

10. Nga sa referuam me sipër si edhe bazuar në dokumentacionin e publikuar nga autoriteti kontraktor në SPE, nuk rezulton që të ketë një Analizë teknike me zërat përkatës të punimeve ku për secilin prej këtyre zërave të ketë konkluzione se përse janë kërkuar një numër përkatësish specialistësh. Është e vërtetë se autoriteti kontraktor ka të drejtën të hartojë kriteret e kualifikimit por është po ashtu e vërtetë që hartimi i tyre duhet të mirë argumentohet dhe analizohet pasi në të kundërt do të kemi të bëjmë me vendosjen e kriterëve mbi hamendesime dhe jo mbi bazën e nevojave specifike për secilin zë punimesh.
11. Nga sa me sipër, kërkojmë publikimin e analizës teknike ose heqjen e kriterëve të pa argumentuara mbi bazën e një analize të qartë teknike dhe ligjore.
12. **Se dyti**, kërkesa për .....”certifikate të sigurimit teknik leshuar nga institucione të autorizuar nga /ish (IQT) e cila të jetë e leshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë....., është një kërkesë e pa argumentuar dhe në shkelje të legjislacionit në fuqi, është një kërkesë e paligjshme.

13. **Komisioni i Prokurimeve Publike me ane te Vendimit K.P.P. 107/2021, date 02.03.2021, ka hedhur poshte kerkesen per IQT per profesionet jo Elektricista. Konkretisht:**

*III.6.5. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këtë kontekst, referuar volumit të kontratës që prokurohet, si dhe preventivit të punimeve, në të cilin parashikohen punime elektrike që kërkojnë ekspertizë të thelluar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e ka gjykuar si të domosdoshme kërkesën për punonjësit e kualifikuar nga ISHTI ose ekuivalent, të lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim me kontratën objekt shqyrtimi. Komisioni thekson se, trajnimi i punonjësve dhe pajisja e tyre më dëshminë për kualifikimin të sigurimit teknik, është e detyrueshme për të gjithë punonjësit që përdorin pajisje elektrike në proceset e punës.*

*Në këto kushte, Komisioni gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor për pajisjen me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të 4 punonjësve elektrikistë në grupin IV, si dhe 1 inxhinieri elektrik e 5 punonjësve elektrikist në grupin V, është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përpjesëtim me proceset e punës që parashikohen dhe volumin e kontratës që prokurohet. KPP thekson se referuar preventivit të zbatimit të punimeve janë parashikuar zëra specifike të punimeve elektrike të cilat kërkojnë staf teknik të specializuar, siç janë edhe spostimi i linjës së tensionit të lartë (përfshirë shtyllat), furnizim vendosje e xhuntove të bashkimit për linjat e tensionit.”*

Pra ligjerisht deshmit e sigurimit teknik kerkohen vetem per ata punonjes qe jane elektricista pra qe kryejne punime elektrike të cilat kërkojnë staf teknik të specializuar, siç janë edhe *spostimi i linjës së tensionit të lartë (përfshirë shtyllat), furnizim vendosje e xhuntove të bashkimit për linjat e tensionit.*

14. Nga sa me sipër, kerkojme heqjen e kerkeses per IQT ose ekuivalente per punonjesti si ne vijim:

- 4 (kater) Punonjës hidraulikë
- 3 (tre) Punojes termohidraulike
- 3 (tre) Punonjes mekanikë
- 1 (nje) Punonjës kaldaist
- 4 (kater) Punonjes pllakashtrues

15. **Se treti**, kerkesa per disponimin nga operatoret ekonomik te: - **1 (nje) Punonjës elektromekanik** eshte nje kerkesë teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar teknikisht, pasi eshte kerkuar njehet mekanik dhe nuk mund te rendohen operatoret edhe me nje punonjes

elektro-mekanik. Nëse autoritetit i nevojitet një elektrikist atëherë duhet të modifikojë kriterin dhe jo të kërkojë elektro-mekanik por të kërkojë elektrikist ose të heqë fare kriterin.

16. **Se katërti**, kërkesa për disponimin nga operatorët ekonomikë të: - **I (një) Punonjës kaldaist** është një kërkesë teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar teknikisht, pasi referuar zerave të preventivit nuk rezulton në anje pikë zeri kaldataje.

Për këto arsye, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë.

17. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

18. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të LPP-së.

### III. Ne dokumentate tenderit ka pasaktesi pasi:

19. Referuar Specifikimeve Teknike, rezulton te jete kerkuar – *Radiator me Bllok Celiku*, nderkohe referuar ketij zeri ne Preventiv rezulton te jete kerkuar- *Radiator me Element Alumini*, pra kemi te bejme me nje mosperputhje thelbesore e cila duhet te saktsohet duke modifikuar dokumentat e tenderit.

### IV. Ne piken 2.3.7, te kapacitetit teknik, te Kriteve te Veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar:

- 2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/ certifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë Gusht 2023 të paktën;*

*1 (një) punonjës që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier" Ose kontratë shërbimi.*

20. Kerkesa per vertetimin e disponimit te punonjesit me 3 dokumenta eshte teresisht I ekzagjeruar dhe aspak I argumentuar. Nese ke kerkuar lispagesen athere nuk mund te kerkohet edhe kontrata e punes e cila verteton te njejten gje. Per kete arsye, kerkojme modifikimin e kerkeses duke hequr tere ato barrier dhe duke lene si kerkesa ose listpagesen ose kontraten e punes. Per me teper qe kontrta e punes nuk kontrollohet nga cdo autoritetet pasi eshte konfidenciale dhe autoriteti kompetente per ta kontrolluar eshte Inspektoriati I Punes.

21. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të*

kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

22. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

23. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të LPP-së.

#### V. **Ne piken 2.3.8, te kapacitetit teknik, te Kriterëve te Veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar:**

**2.3.8** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane. Mbështetur në: Ligj Nr.9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

24. **Se pari**, kerkesa qe licenca e referuar me siper, te jete edhe per Grumbullim dhe Ruajtje, ne nje kohe qe ne preventive nuk ka asnje ze per grumbullim apo ruajtje eshte totalisht e paligjshme dhe si e tille duhet te hiqet si kriter.

25. **Se dyti**, kerkesa qe licenca e referuar me siper, te jete per mbetje urbane ne nje kohe qe ne preventive nuk ka asnje ze per mbetje urbane por per mbetje inerte nga punimet, eshte gjithashtu shkelje e paster e ligjit te prokurimeve publike.

26. **Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi qe merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane te Vendimit K.P.P. 107/2021, datës 02.03.2021, eshte shprehur se kerkesa per licenca per Mbetje Urbane, nuk ka vend ne ndertim dhe se kjo kerkese eshte joproporcionale dhe e paligjshme: “III.8.7. Lidhur me pretendimet e ankimesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e Licencës të lëshuar nga QKL për**

grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B), Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik, e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe grumbullimi transporti i mbetjeve të ngrurta (inerte dhe dherave) mbetje kto të cilat do të dalin kryesisht si rezultat i kryerjes së punimeve për realizimin e kontratës, gjatë kryerjes së veprimtarisë. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve për largimin e mbetjeve inerte. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër, KPP gjykon se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventiviti, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë së largimit dhe transportimit të mbetjeve inerte. Por, autoriteti kontraktor ka kërkuar licencën e gabuar në dokumentat e tenderit, pasi gjatë zbatimit të kontratës **nuk është parashikuar grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, në kuptim të ligjit nr.8094 datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”**. Komisioni thekson se kërkesa joproporcionale mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë në fazën e vlersimit të ofertave. Ndaj në këtë kuptim, Komisioni gjykon se **autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit, duke kërkuar paraqitjen e Licensës me Kodin III.2.B në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.**”

27. Nga sa me sipër, kerkojme **heqjen e kriterit** ose modifikimin e saj si ne vijim:

*Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Transportim, e mbetjeve inerte.*

28. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*



3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

29. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

30. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të LPP-së.

**VI. Ne piken 2.3.9 dhe 2.3.10, te kapacitetit teknik, te Kriterëve te Veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar:**

2.3.9 Për materialet (pompa, tuba) operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori të autorizuar duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit.

2.3.10 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit, certifikatat e cilesise ose deshmi të testeve zyrtare me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

31. **Se pari**, duam e theksojme se referuar zerave në preventivin e publikuar në SPE nga autoriteti kontraktor, rezulton se nuk ka asnjë zë për Pompa, çka do të thote se kërkesa për autorizim prodhuesi apo distributor për Pompe, është teresisht e paligjshme dhe si e tillë duhet të hiqet.

32. **Se dyti**, në nenin 7 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar parashikohet se: "Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset

detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht, dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe **është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.**”

33. Referuar parashikimeve ligjore të mësipërme, materialet bashkë me çertifikimet e cilësisë paraqiten në fazën e punimeve dhe subjekti kompetent për kontrollin e tyre është një subjekt i pavarur, ne rastin konkret Mbikëqyrësi i Punimeve, i cili do të paguhet nga Autoriteti Kontraktor për të bërë **kontrollin e cilësisë së punimeve dhe materialeve** përpara se ato të vendosen në objekt.
34. Shoqëritë ndërtuese nuk janë të detyruara ligjrisht të kenë një marrëdhënie direkt me prodhuesin/distributorin pasi materiale të tilla shiten rëndom në tregun e lire dhe përdorimi i këtyre materialeve sipas cilësisë së kërkuar në ndërtim do të bëhet nëpërmjet çertifikimeve të cilësisë të cilat bëhen në fazën e ndërtimit dhe jo të tenderimit. E theksojmë edhe njëherë se është detyrë e Mbikëqyrësit të Punimeve që të bëjë kontrollin e cilësisë së materialit që do të përdoret për realizimin e objektit dhe është po detyrë e tij që të përcaktojë nëse punimet janë kryer në cilësi dhe brenda parametrave të kërkuara në fushën e ndërtimit.
35. Gjithashtu, vlen të theksohet se autoriteti kontraktor nuk mund ti jap Komisionit të Vlerësimit të Ofertave tagrat e Mbikëqyrësit të Punimeve dhe të kontrollojë materialet në këtë fazë.
36. Jemi të vetëdijshëm se është e drejta e autoritetit kontraktor, që të përcaktojë kriteret për një procedurë prokurimi, por në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj, si dhe në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në këtë rast nuk kemi një procedurë për blerje mallrash por një procedurë punë/ndërtim, kontrolli për saktësinë dhe cilësinë bëhet vetëm nga mbikëqyrësi i punimeve.
37. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
  - b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
  - c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*
- Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të*

*kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

38. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

39. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të LPP-së.

#### VII. Ne piken 2.3.11 te Kriterëve te Veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar:

- 2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike si më poshtë vijon;

Nr.	Emri i mjetit	Njesi	Sasia	Statusi
1.	Kamioncine (kapaciteti total mbajtës deri ne 3.5 ton)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
2.	Gjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
3.	Prese hidraulike	Cope	4	Në pronësi ose me qera
4.	Aparat saldimi	Copë	2	Në pronësi ose me qera
5.	Gershere mekanike	cope	4	Në pronësi ose me qera
6.	<b>Betoniere kantieri 0.25 m<sup>3</sup></b>	<b>Copë</b>	<b>2</b>	<b>Në pronësi ose me qera</b>
7.	Matrapik	Copë	4	Në pronësi ose me qera
8.	Matravide	Copë	2	Në pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 47 (dyzet e shtatë) copë
- Jelekë minimumi 47 (dyzet e shtatë) copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 (dhjetë) copë
- **Prozhektorë ndriçimi minimumi 5 (pesë) copë**

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë
- a) Makineritë dhe pajisjet në pronësi të shoqërohen me dokumentacion vërtetues për disponimin e tij (akt zhdoganimi dhe/ose faturë blerje dhe/ose çdo dokumentacion ligjor që e vërteton).
  - b) Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me **kontrata qiraje** të lidhura para **noterit** publik me emër objekti, si dhe të shoqërohen me aktin e vërtetimit të pronësisë të qiradhënësit.
  - c) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të jetë e shtrirë në një kohë brenda afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
  - d) Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.
  - e) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese.
40. **Se pari**, kërkesa që ka të bëjë me - **Betoniere kantieri 0.25 m<sup>3</sup>**, pra që Betonierja të jetë me mase *fikse 0.25m<sup>3</sup>*, është një kërkesë perjashtuese dhe diskriminuese për operatorët ekonomik që disponojnë Betoniere të një kapaciteti më të vogël apo më të madhë. Bazuar në legjislacionin e prokurimeve publike, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë minimumin e kapacitetit pa vënë kufizim me peshe fikse. Për këtë arsye, kërkojmë modifikimin e kërkesës duke vendosur minimumin apo maksimumin e kapacitetit të betonieres.
41. **Se dyti**, kërkesa për: - Kokore minimumi 47 (dyzet e shtatë) copë-Jelekë minimumi 47 (dyzet e shtatë) copë është një kërkesë teresisht jo proporcionale me objektin e prokurimit si edhe e pa mbështetur në një Analizë teknike të detajuar dhe mireargumentuar se përse nevojitet një numër kaq i madhë pajisjesh.
42. Për këtë arsye, kërkojmë reduktimin e numrit të pajisjeve në përputhje me numrin që i nevojitet autoritetit kontraktor për realizimin e objektit me sukses. Në rastin konkret, nuk mund të kërkojë më shumë se 18 copë nga këto pajisje numër i cili lidhet ngushtesisht me numrin e punonjësve të certifikuar të kërkuar në pikën **2.3.6** të kritereve të vecanta të kualifikimit që kanë të bëjnë me:
- 4 (kater) Punonjës hidraulikë
  - 3 (tre) Punonjës termohidraulikë
  - 3 (tre) Punonjës mekanikë
  - 1 (një) Punonjës elektro-mekanik
  - 2 (dy) Punonjës saldatorë
  - 1 (një) Punonjës kaldaist
  - 4 (kater) Punonjës pllakashtrues

43. **Se treti**, kërkesa që ka të bëjë me - **Prozhektorë ndriçimi minimumi 5 (pesë) copë**, është teresisht e paligjshme pasi referuar dokumentave të tenderit nuk rezulton në anje pike që punimet do kryhen edhe naten. Në këto kushte, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë teresisht të pallogjikshme dhe të paligjshme.
44. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
  - b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
  - c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*
- Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
- Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*
- Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
- Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
- Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

45. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

#### **VIII. Ne piken 2.3.11, shkronja b) te Kriterëve te Veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar:**

"Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik me emër objekti, si dhe të shoqërohen me aktin e vërtetimit të pronësisë të qiradhënësit."

46. Komisioni i Prokurimeve Publike, me ane te Vendimit Nr.206/2024, date 21.02.2024, ka vendosur se kërkesa qe kontrata e qirase se mjeteve te jete noteriale, eshte e paligjshme. Konkretisht:

III.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin



dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Për sa i përket pretendimit të ankimesit "kërkojmë heqjen e kërkesës që kontrata të jetë noteriale", Komisioni i Prokurimit Publik referuar Kodit Civil përkatësisht nenit 801, është e shprehur qartë, se "Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar" dhe në nenin 803 të Kodit Civil është cituar, se "Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë". Pra përcaktohet qartë, se kontratat e qirasë për pasuritë e paluajtshme bëhen me akt noterial, ndërsa kontratat e qirasë për pasuri të luajtshme, nuk është detyrim të bëhen me akt noterial.

Gjithashtu, referuar Kodit Civil, përkatësisht nenit 901 mbi huapërdorimin, shprehet qartë në ligj, se nuk është përcaktuar forma e detyrueshme, që kontrata e huapërdorjes duhet të jetë me akt - noterial.

Komisioni i Prokurimit Publik e gjen të tepërt kërkesën e Autoritetit Kontraktor lidhur me kontratën e qirasë/huapërdorjes, me akt noterial për mjetin e transportit, që do të shërbejë për lëvrimin e mallit, duke ngarkuar me barrë të panevojshme operatorin ekonomik, për të lidhur kontratë me akt - noterial. Për autoritetin kontraktor është i rëndësishëm disponimi nga operatori ekonomik, i një mjete transporti të kërkuar. Provueshmëria lidhur me këtë kapacitet mund të bëhet edhe me një kontratë qiraje/huapërdorje të lidhur mes palëve konform dispozitave të parashikuara në legjislacionin përkatës, duke ofruar garanci dhe siguri për autoritetin kontraktor, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin 2.3.3, **në heqjen e termit "e noterizuar" në kontratën e qirasë/huapërdorjes për mjete transporti, me qëllim për të lehtësuar operatorët ekonomikë, për pjesmarrje në procedurën e tenderimit, në kushtet kur forma noteriale e kërkuar, nuk është e detyrueshme referuar parashikimeve ligjore në fuqi.**

Kërkesa e operatorit ekonomik qëndron.

Nga sa me sipër, kërkojmë heqjen e kërkesës që kontrata të jetë noteriale.

**IX. Ne zerat e preventivit që kanë të bëjnë me Impiantin e Ngrohjes/Sistemi Hidronik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar:**

PUNIME PËR INSTALIMIN E SISTEMEVË MEKANIKE						
IMPIANTI I NGROHJES						
SISTEMI HIDRONIK						
1	An-N. 4	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 3/4 "	kg	12		
2	An-N. 5	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 1 "	kg	652		
3	An-N. 6	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 1 1/4 "	kg	568		
4	An-N. 7	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 1 1/2 "	kg	468		
5	An-N. 8	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 2 "	kg	320		
6	An-N. 9	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 2 1/2 "	kg	244		
7	An-N. 10	F.V Tuba çeliku pa tegel + rakorderi, Ø 3 "	kg	688		

47. Nga sa me siper, konstatojme se autoriteti kontraktor ka kerkuar ne menyre eskluzive Tuba celiku pa Tegel, nderkohe qe ne tregun boterore dhe ate vendas rezulton te kete edhe Tube Celiku me Tegel qe permbush te njejtin funksion dhe cilesi.

48. Persa me siper, kerkojme modifikimin e zerave te referuar me siper duke perfshire edhe Tubat e Celikut me Tegel.

**Nga sa parashtruam me siper si dhe duke ruajtur te drejten per te paraqitur argumenta dhe prova shtese:**

- Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin perfundimtar te kesaj ankese;
- Modifikimin e kriterave sipas percaktimeve te bera nga shoqeria jone;

#### **5. Kerkese per ekspertize te posacme**

Po

Jo

*(Nese po, specifikoni llojin e ekspertizes qe kerkoni)*

#### **6. Kerkese per perjashtim te zyrtareve qe do te merren me shqyrtimin e ankeses**

#### **7. Lista e informacionit konfidencial:**

*Percaktoni se cili informacion eshte konfidencial, nese ka. Shpjegoni pse informacioni eshte ose nje version i dokumenteve perkatese me heqjen e pjeseve konfidenciale dhe nje permbledhje te permbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkelidhe ankimit, qe do te paraqese ne autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar qe verteton pagesen e tarifes perkatese per ankesen prane Komisionit te Prokurimit Publik***

Dergojeni formularin e plotesuar te ankeses se prokurimit, te gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtese, prane **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shenim: Ankimuesi duhet ta dergoje njekohesisht ankesen ne autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

E-mail: [juristkevin@gmail.com](mailto:juristkevin@gmail.com)

**Shoqeria “Kevin Konstruksion” Sh.p.k**

**Administrator**

**Lavdrim Gjici**

